




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije -Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation
Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Datë: 26.11.2025

Numër: 01-182

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), nën paragrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 34, 18 Nëntor 2022), nenit 32 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2023 për krijimin e skemave për mbështetje financiare të studentëve për ndarjen e bursave, nxjerr këtë:

V E N D I M
për përzgjedhjen e studentëve përfitues për kërkime postdoktorale

1. Përzgjedhen studentët përfitues për bursat postdoktorale në 1000 universitetet më të mira në botë, sipas renditjes së listës "QS World University" për periudhën 2025/2026 në kuadër të Programit Kombëtar të Shkencës 2023-2028 lidhur me implementimin e prioritetëve kombëtare, si në vijim:

Nr.	Emri e mbiemri	Renditja	Universiteti
1.	QËNDRESA MORINA	473	University Johannes Kepler
2.	ERMIRA KRASNIQI BOSHJAKU	534	University of Connecticut
3.	BASTRI ZEKA	535	University of Ljubljana
4.	ARLINDA CAKAJ	688	Université Côte D'Azur
5.	NAIME BRAJSHORI	751-760	Martin-Luther-Universitat Halle - Wittenberg
6.	KIMETE CANAJ	951-1000	Uniwersytet Łódzki

2. Në pajtim me Vendimin 01-143 të datës 16.09.2025, studenti/ja sipas pikës 1 të këtij vendimi përfiton mbështetje financiare në shumën prej 10.000 euro për vitin akademik 2025/2026.

3. Studentët përfitues janë të obliguar që të zbatojnë të gjitha obligimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi si dhe kriteret e konkursit të datës 29.09.2025.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në Raportin e Këshillit Shkencor të datës 10.11.2025, kërkesën e datës 20.11.2025 për mbështetjen financiare për kërkime postdoktorale në 1000 universitetet më të mira në botë, sipas renditjes së listës "**QS World University**" për periudhën 2025/2026 në kuadër të Programit Kombëtar të Shkencës lidhur me implementimin e prioritetëve kombëtare, sipas konkursit të datës 29.09.2025 si dhe Vendimit 01-143 të datës 16.09.2025, në pajtim me legjislacionin në fuqi u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtë në afat prej shtatë (7) ditësh pas publikimit të rezultateve, në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave tjera në MASHTI.


Arbërie Nagavci
Ministre në detyrë/MASHTI

Vendimi u dërgohet:

1. *Të lartpërmendurve;*
2. *Kabinetit të Ministres/MASHTI;*
3. *Zyrës së SP/MASHTI;*
4. *DALSHTI/MASHTI;*
5. *Arkivit MASHTI.*